



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1242/7 Prot

Tiranë, më 9.7.2024

V E N D I M

Nr. 17, datë 09.07.2024

M B I

**SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT “NISATEL”  
SH.P.K, KUNDËR MASËS ADMINISTRATIVE TË DËNIMIT ME GJOBË**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.2024, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullores Nr. 46 datë 27.10.2016, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues, si dhe Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të komisionit *ad hoc* shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Shqyrtimi i ankimit administrativ të sipërmarrësit “Nisatel” sh.p.k, kundër masës administrative të dënimit me gjobë.**

## BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Rregullore Nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”.
3. Rregullore Nr. 46 datë 27.10.2016, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.
4. Rregullore Nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
5. Rregullore Nr. 26, datë 16.08.2012 “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në RSH”;
6. Rregullore Nr. 22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndër urbane të komunikimeve elektronike”.

## K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:


1. Ankimi administrativ i subjektit “Nisatel” sh.p.k, depozituar në AKEP me datë 18.06.2024, me Nr.1242/4 prot. i AKEP;
2. Relacioni i komisionit *ad hoc*, ngritur me urdhrin nr.97, datë 25.06.2024, “Për ngritjen e komisionit *ad hoc* për shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “Nisatel” sh.p.k;
3. Projekt-Vendimin e formatuar dhe arsyetuar;
4. Relacionin shoqërues të Projekt-Vendimit, i hartuar nga Komisioni *ad hoc* i ngritur për shqyrtimin e ankimit administrativ (Relacioni);
5. Praktikën e plotë të inspektimit, e cila përmban materialet si vijon: Autorizimin e Inspektimit Nr. 1242 Prot, datë 09.05.2024 ; Procesverbalin e Inspektimit nr. 24. Datë 24.05.2024; Vendimin Përfundimtar të Inspektimit Nr.11, datë 05.06.2024; Gjobjën me numër serie 0000004, datë 05.06.2024.

Si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

### I. Vlerësimi Paraprak:


1. Sipërmarrësi i Komunikimeve Elektronike “Nisatel” sh.p.k ka paraqitur ankimin administrativ brenda afatit të parashikuar në nenin në nenin 136, të Ligjit Nr.9918, datë



19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikës 3.9 të Rregullores Nr. 46 datë 27.10.2016, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, si dhe ankimi administrativ plotëson efektivisht të gjitha kushtet formale për pranimin e shqyrtimit të ankimit, të parashikuara në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

## II. Rrethanat e Çështjes:

2. Me Autorizimin e Inspektimit Nr. 1242 Prot, datë 09.05.2024, Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit të sipërmarrësit “Nisatel” sh.p.k, njoftuar me e-mailin e datës 09.05.2024.
3. Inspektimi i subjektit “Nisatel” shpk. u krye me tematikë si më poshtë:
  - Verifikimin e zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
  - Zbatimit të Rregullores Nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”.
  - Verifikimin e kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP lidhur me masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të parashikuara në Rregulloren Nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
  - Verifikimin e rregullave për përdorimin e përbashkët të faciliteteve të parashikuara në Rregulloren Nr. 35, datë 10.07.2015 “Rregulla për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe asetëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”;
  - Verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në Rregulloren Nr. 49, datë 11.03.2021 për “Mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”;
  - Verifikimin e zbatimit të rregullave teknike të parashikuara në Rregulloren Nr. 26, datë 16.08.2012 “Për përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në RSH”;
  - Verifikimin e zbatimit të kushteve teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve të parashikuara në Rregulloren Nr. 22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndër urbane të komunikimeve elektronike”.
  - Verifikimin e kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave dhe numeracionit;
  - Verifikimin e kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP lidhur me:



- *Publikimin e informacionit për tarifat, aksesit dhe përdorimit të shërbimeve;*
  - *Termet dhe kushtet e përgjithshme të kontratave të pajtimit.*
4. Sipërmarrësi “Nisatel” shpk, është njoftuar në rrugë elektronike (e-maili i dt. 09.05.2024) mbi Autorizimin e Inspektimit nr. 1242 prot, datë 09.05.2024.
5. GI, pasi administroi dokumentacionin e kërkuar sipas tematikës së përcaktuar në Autorizimin e Inspektimit, si dhe pasi inspektoi subjektin në vendin e ushtrimit të veprimtarisë, konstatoi se:
- Në faqen web të sipërmarrësit Nisatel sh.p.k nuk ishte publikuar “Udhëzuesi” rreth *incidenteve më të zakonshme të sigurisë*, i cili shërben për të informuar dhe mbrojtur pajtimtarët dhe për t’i udhëzuar rreth veprimeve dhe/ose mjeteve si dhe protokolleve që duhen ndjekur për të parandaluar ndodhjen e këtyre incidenteve. Ky detyrim buron nga parashikimet e sanksionuara në rregulloren Nr.37 datë 29.10.2015 “*Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike*”.
  - Sipërmarrësi Nisatel shpk nuk ka dërguar në AKEP (në sistemin e raportimeve online, protokoll apo e-mail), Raportin e Sigurisë, detyrimi i cili buron nga Rregullore Nr. 37 datë 29.10.2015 “*Mbi masat Teknike dhe Organizative për te garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike*”.
  - Në zbatim të Rregullore Nr.37 datë 29.10.2015 “*Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike*” sipërmarrësi **duhet të marrë masat e duhura gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura**, në mënyrë që të garantojnë dhe të sigurojnë një nivel të mbrojtjes dhe sigurisë së përshtatshme ndaj rreziqeve të mundshme, të parashikuara. **Sipërmarrësi duhet të kryejë të gjithë sistemimin e kabllimit dhe të pajisjeve sipas rregullave teknike me qëllim garantimin e nivelit të sigurisë në përputhje me rreziqet eventuale që mund të paraqiten.**
  - **Në lidhje me respektimin e kufizimeve me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, nga inspektimi rezultoi se Sipërmarrësi i Komunikimeve Elektronike “Nisatel” Sh.p.k nuk plotësonte detyrimin ligjor mbi bllokimin e çdo faqe interneti me përmbajtje të paligjshme, apo të dëmshme sipas udhëzimeve të institucioneve ligj zbatuese dhe vendimmarrëse, të përcjella nga AKEP.**
6. Më datë 24.05.2024, GI hartoi dhe më pas njoftoi subjektin me Proces-Verbalin e Inspektimit Nr. 24, datë 24.05.2024, ku parashikohej marrja e masës kryesore administrative me gjobë, si dhe dënimi administrativ plotësues.
7. GI klasifikoi shkeljet e sipërcituara si kundërvajtje administrative, për të cilat parashikohet dënimi me masën administrative kryesore me gjobë, në bazë të paragrafit

VII të nenin 137 të Ligjit nr. Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

8. Sipërmarrësit të Komunikimeve Elektronike “Nisatel” sh.p.k iu la afat 8 (tetë) ditë me qëllim paraqitjen e shpjegimeve apo kontestimeve të tij. Në kushtet kur sipërmarrësi nuk paraqiti ankim në AKEP, G.I vijoi me marrjen e Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr. 11, datë 05.06.2024.

Në vendimin përfundimtar, për shkak të shkeljeve të konstatuara, në mbështetje të paragrafit VII, të nenit 137, të ligjit nr. Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, G.I vendosi të dënojë sipërmarrësin “Nisatel” shpk me masën administrative “gjobë” në vlerën 100 000 mijë lekë dhe me urdhërimin për të korrigjuar shkeljet e konstatuara.

9. Vendimi Përfundimtar i Inspektimit nr. 11 prot, datë 05.06.2024 si dhe akti administrativ “Gjobë” me numër serie 0000004, datë 05.06.2024 në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, iu përcoll në formë shkresore subjektit “Nisatel” sh.p.k.
10. Pas marrjes së njoftimit për Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, sipërmarrësi Nisatel sh.p.k i është drejtuar Këshillit Drejtues të AKEP me ankimin administrativ nr.347, datë 13.06.2024 (Nr.1242/4 prot i AKEP, datë 18.06.2024), duke kërkuar:


- Ndryshimin e masës administrative “Gjobë” sipas Vendimit Përfundimtar të Inspektimit Nr.11, datë 05.06.2024, të vendosur nga inspektorët e AKEP, në dënim administrativ kryesor **“Paralajmërim”**.

### KËSHILLI DREJTUES I AKEP

Pasi mori në shqyrtim shkresën Nr. 1242/4 Prot, datë 18.06.2024, (ankimin administrativ të sipërmarrësit “Nisatel”) dhe shqyrtoi materialet pjesë përbërëse të dosjes së inspektimit, konstatimet dhe konkluzionet e arritura në përfundim të procesit të inspektimit,

### ARSYETON:

11. Në zbatim të Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” Grupi i Inspektimit ka kryer veprimet procedurale duke zhvilluar procedurë inspektuese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Grupi i Inspektimit ka njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e subjektit “Nisatel” shpk, me postë elektronike duke i dërguar bashkëngjitur kopjen e Autorizimit të Inspektimit Nr. 1242 Prot, datë 09.05.2024.
12. Gjatë verifikimit dhe procedurës inspektuese, ka rezultuar se subjekti Nisatel sh.p.k ka kryer shkelje të përcaktimeve të nenit 15 të Ligjit nr. 9918, i ndryshuar “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores Nr. 47, datë 26.10.2017 “Për Zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm” si dhe Rregullores



Nr. 37, datë 29.10.2015 “Mbi masat Teknike dhe Organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

13. Kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo person tjetër fizik a juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara:
- b) vendosin gjobë, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët V deri në VIII të tij dhe kërkojnë marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur një afat për realizimin e saj.
14. Shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit që lidhen me mos zbatimin e kushtit të respektimit të kufizimeve në lidhje me faqet web me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, mos publikimin e Udhëzuesit rreth incidenteve më të zakonshme të sigurisë, mos dërgimi në AKEP i Raportit të Sigurisë, klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative sipas paragrafit VII të Nenit 137, të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918).
15. Në vendosjen e masës administrative janë marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në Rregulloren Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, përfshirë rëndësinë e shkeljes së konsumuar referuar parashikimit ligjor dhe pasojës/dëmit që ka shkaktuar.
- Ligji Nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” përcakton se: “Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim.”
16. Në përfundim të procedurës për shqyrtimin e ankimit dhe të pretendimeve të sipërmarrësit “Nisatel” shpk, pas arsytimit dhe akteve të paraqitura nga Grupi i Inspektimit, si dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, konstatohet se, vendosja e masës administrative “Gjobë” për ligjet administrativisht pasi është e bazuar në dispozitat materiale dhe procedurale të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Rregullores Nr. 46 datë 27.10.2016, “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” dhe si i tillë duhet të mbetet në fuqi.
17. Me shkresën Nr.347, datë 13.06.2024 (Nr. 1242/4 Prot. i AKEP, datë 18.06.2024), sipërmarrësi në bazë të nenit 136 të ligjit nr. 9918/2008, ka paraqitur ankim administrativ pranë Këshillit Drejtues të AKEP.
18. Konkretisht, në ankimin e tij sipërmarrësi Nisatel shpk lidhur me shkeljet e konstatuara nga GI ka parashtruar se:

- **Lidhur me bllokimin e faqeve web pretendon** se në PC e testuar nga grupi inspektimit ishin vendosur, për shkaqe teknike, DNS të ndryshme nga ato të “Nisatel” prandaj këto faqe hapeshin.

Referuar rregullores 47, datë 26.10.2017, “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, Aneksi E, pika 9, për “Respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme”, nënpika 9.2, operatori i komunikimeve elektronike detyrohet “që të marrë masat e duhura juridike dhe teknike për zbatimin e kufizimit të kërkuar”; Nga ana tjetër, nënpika 9.4, detyron operatorin e komunikimeve elektronike “të veprojë menjëherë për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit të përmbajtjes”.

Referuar dy nënpikave të sipërpërmendura, në asnjë rast operatori i komunikimeve elektronike, nuk mund të kryejë bllokim të pjesshëm të përmbajtjeve të paligjshme dhe i takon vetë operatorit për të kryer implementimet e duhura teknike për të zbatuar detyrimin ligjor.

Gjithashtu, operatori “Nisatel” paraqet si provë edhe “log”-et e fundit kur janë kryer ndërhyrje në “blacklist” (lista e domain-eve të bllokuar) që mbajnë dt. 13.05.2024, për të faktuar gadishmërinë për bllokimin e përmbajtjeve të paligjshme, menjëherë pas njoftimeve të AKEP.

- Së dyti **“Udhëzuesi” rreth incidenteve më të zakonshme të sigurisë**, detyrim i cili buron nga Rregullorja Nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat Teknike dhe Organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, neni 6 Pika 1/J i cili shërben për të mbrojtur klientët dhe për ti udhëzuar rreth veprimeve dhe/ose mjeteve që duhen ndjekur për të parandaluar ndodhjen e këtyre incidenteve dhe veprimeve që duhen ndjekur pas ndodhjes së incidenteve të sigurisë, është publikuar pas procedurës së inspektimit.
- **Lidhur me sistemimin e kabllimit** të pajisjeve sipas rregullave teknike me qëllim garantimin e nivelit të sigurisë në përputhje me rreziqet eventuale që mund të paraqiten, sipërmarrësi pretendon se sistemimet e tilla do t’i realizojë pasi të ngrenë një Data Center të ri, të parashikuar në buxhetin e vitit 2024.
- **Në lidhje me dërgimin e Raportit të Sigurisë**, detyrim i cili buron nga Rregullore Nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat Teknike dhe Organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, pretendohet se u dërgua në AKEP pasi u njoh nga grupi i inspektimit. Gjithsesi për këtë detyrim, Rregullorja Nr. 37 datë 29.10.2015, përcakton qartë se: *Te gjithë sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të dërgojnë informacion të detajuar për të vlerësuar sigurinë dhe/ose integritetin e shërbimeve dhe rrjeteve në AKEP periodikisht një herë në vit, brenda muajit Janar për vitin paraardhës, sipas Aneksit 3 të kësaj rregulloreje.*

Në këto kushte, shkeljet e konstatuara nga grupi i inspektimit që lidhen me mos zbatimin e kushtit të respektimit të kufizimeve në lidhje me faqet web me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, mos publikimi i Udhëzuesit rreth incidenteve më të zakonshme të sigurisë, mos dërgimi në AKEP i Raportit të

Sigurisë, klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohet dënim administrativ sipas përcaktimeve të paragrafi VII, Nenit 137, të ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në zbatim nenit 128 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Drejtues i AKEP,


### **V E N D O S I:**

1. Të rrëzojë ankimin administrativ të sipërmarrësit “Nisatel” sh.p.k.
2. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar të inspektimit Nr.11, datë 05.06.2024, si dhe Gjobën me numër serie 0000004, datë 05.06.2024.
3. Ngarkohet DMKI, të njoftojë sipërmarrësin “Nisatel” sh.p.k, për këtë vendim.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, sipas afateve ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Tomi Frashëri**




**Anëtar**

**Edlira Dvorani**



**Anëtar**

**Blëron Dokle**



**Anëtar**

**Armer Juka**

